



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT TIRANË**

# **ANALIZË VJETORE**

**2012**

*- Shkurt 2013 -*

## **PËRMBAJTJA**

<b><i>Fjala e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë</i></b>	<b>3</b>
<b>I. <i>Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2012</i></b>	<b>6</b>
<b>II. <i>Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2012</i></b>	<b>12</b>
<b>III. <i>Ngarkesa individuale e punes se gjyqtareve</i></b>	<b>13</b>
<b>IV. <i>Cilësia në Gjykim</i></b>	<b>15</b>
<b>V. <i>Shpejtësia në Gjykim</i></b>	<b>16</b>
<b>VI. <i>Përmbledhje e çështjeve të mbartura nga viti 2012</i></b>	<b>16</b>
<b>VII. <i>Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë gjykuar në Gjykatën e Lartë</i></b>	<b>17</b>
<b>VIII. <i>Administrimi i fondeve për vitin 2012</i></b>	<b>20</b>

Fjala e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë  
z. Alaudin Malaj

***I nderuar Zv.Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Elvis Çefa,***

***Të nderuar kolegë pjesëmarrës,***

Analiza vjetore e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë, paraqitet në respektim dhe përmbushje të detyrimeve ligjore në zbatim të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit mbi “Organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”.

Me anë të këtij raporti analitik, përcillet në mënyrë të plotë dhe të detajuar veprimtaria organizative e Gjykatës së Apelit Tiranë, ku në të evidentohet analiza treguesve të kësaj veprimtarie shoqëruar me të dhëna statistikore në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të çështjeve të mbërritura pranë kësaj gjykate gjatë vitit 2012 si dhe veprimtaria ekonomike e financiare e kësaj periudhe.

Gjykata e Apelit, nëpërmjet veprimtarisë së saj, së bashku me gjykatat e dy niveleve të tjera të gjyqsorit, luan një rol të rëndësishëm në rritjen e besimit të publikut tek drejtësia, rritjen e integritetit moral e profesional të anëtarëve të sistemit gjyqësor, mbrojtjen e figurës së gjyqtarit dhe statusit të tij.

Drejtësia është një shërbim i rëndësishëm publik, prandaj është e drejtë e publikut të monitorojë e ta kontrollojë atë në çdo hap të saj. Qytetari i Republikës së Shqipërisë, si një vend me aspirate të larta, duhet të sigurohet se vendimet e gjykatës janë dhënë ndershmërisht, nga një staf i përkushtuar dhe se të dhënat e gjykatës janë të sakta dhe të sigurta.

Si një institucion publik, dedikuar dhënies së drejtësisë, Gjykata e Apelit udhëhiqet nga fryma për të ofruar një shërbim cilësor në interes të qytetarit, në zbatim të kërkesave parimore dhe përgjegjësisë ligjore, në respektim të parimit ndërkombëtar të drejtësisë, atij të nje procesi të rregullt ligjor.

Ne pozicionin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, dëshiroj të theksoj rëndësinë e detyrave të mëdha që kemi vendosur përpara vetes sonë, në kuadër të procesit gjithpërfshires së reformës në sistemin e drejtësisë, pavarësisë së sistemit gjyqësor, me qëllim përfitimin e nje drejtësie bashkëkohore e cila udhëhiqet nga ligji, profesionalizmi, ndershmëria dhe përkushtimi në kryerjen e kësaj detyre të rëndësishme.

Viti 2012 është viti i parë i mandatit tim në krye të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjatë këtij viti, jam munduar që përvec përmbushjes me dinjitet e profesionalizëm të detyrës në cilësinë e Gjyqtarit të kësaj gjykate, të jem në lartësinë e duhur edhe në cilësinë e drejtuesit të saj. Eksperienca si gjyqtar në Gjykatë Apeli prej 17 vitesh, ka qënë një faktor shumë i rëndësishëm dhe i dobishëm, i cili më ka ndihmuar për të ngritur objektivat e duhura në drejtim të një administrimi të mirë të veprimtarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këtë analizë pune do të paraqesim konkretisht, veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe detyrat që i dalin gjykatës për vitin 2013 e në vazhdim, në vështrim të përmbushjes së detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor” e reformën e gjyqsorit në përgjithësi.

Jam i mendimit se treguesit e punës të kësaj Gjykate kanë shënuar rritje cilësore dhe kjo ka ardhur nga angazhimet në përgjithësi të kolektivit tonë, gjyqtar e punonjës administrate dhe angazhimet në veçanti të gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Është rritur përgjegjësia dhe profesionalizmi i çdo gjyqtari në gjykimin e çështjeve, është rritur debati profesional dhe për rrjedhojë edhe fuqia bindëse e vendimeve të dhëna. Ka më shumë profesionalizëm në arsyetimin e vendimeve dhe më shumë solemnitete në gjykim. Janë krijuar marrëdhënie korrekte me Institucionet e tjera dhe është rritur më tej autoriteti i gjykatës dhe pavarësia e saj në dhënien e drejtësisë.

Ne terminologjinë e përdorur në ditët e sotme koncepti analize vjetore është parë thjesht në këndvështrimin e reklamimit, studimit dhe përllogaritjes së statistikave ose e thënë më thjesht në morinë e çështjeve që janë prishur dhe janë lënë në fuqi.

Në konceptin tim personal në funksion të detyrës së drejtimit të një prej gjykatave më të mëdha dhe të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, analiza përfshin disa aspekte që kanë të bëjnë me:

- 1- Mënyrën se si është krijuar transparenca e plotë tek publiku për veprimtarinë e gjykatës. Se si shërbimet janë bërë më të efektshme dhe më të thjeshta për publikun.
- 2- Integritetin personal të cdo gjyqtari, zbatimin strikt të rregullave që kanë të bëjnë me solemnitetin në gjykim, performancën dhe paraqitjen në respektim të një procesi të rregullt dhe ligjor.
- 3- Dhënien e vendimeve gjyqësore në zbatim dhe përputhje me ligjin, nga një staf i përkushtuar me ndershmëri dhe profesionalizëm.
- 4- Marrëdhëniet e këtij institucioni me institucionet e tjera.
- 5- Veprimtarinë e sektorit të financës në Gjykatën e Apelit Tiranë.

## **I. Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2012**

**Së pari** dua të filloj këtë analize pune me faktin se cfarë kemi bërë ne gjatë vitit 2012 për të rritur transparencën e gjykatës tek publiku.

Sic jemi te gjithë në dijeni, gjykata jonë këtë vit ka qënë në fokus të ndryshimeve të mëdha dhe rrënjësore në lidhje me momentin më kyc që mund t'i ndodhë publikut, faktin e përballjes për herë të parë me institucionin e Gjykatës së Apelit.

Ndryshime të tilla janë: krijimi i sallës me publikun e cila siguron një shkëputje të plotë të imazhit negativ për institucionin dhe gjyqtarët ne përballjen e parë, i cili për hir të vërtetës është momenti më i rëndësishëm i perceptimit të publikut.

Nëpërmjet kësaj salle, e cila në kushtet e tanishme aktuale është në përputhje të plotë me standartet e kërkuara dhe me rregulloren, sigurohet jo vetëm ndenja në mënyrë komode të palëve e të publikut në ambientet e Gjykatës, por gjithashtu edhe nëpërmjet tabelave orientuese, krijimi i shërbimeve cilësore të gjykatës.

Fakti që ambientet e gjykates janë të monitoruara me kamera, bën të sigurohet një perceptim i qartë tek publiku për një institucion të rëndësishëm, te kontrolluar dhe me shërbime efikase.

Gjithashtu drejtimi i publikut për të marr shërbimet në një zyrë të përcaktuar ne gjykatë (Zyrë e cila është krijuar me ndihmën e USAID) krijon premisë pozitive për imazhin e institucionit si dhe për faktin e tregimit të një kujdesi të veçantë të punonjësve të gjykatës në lidhje me kryerjen e shërbimeve në mënyrën, kohen e duhur dhe me qetësi.

Gjykimi i cështjeve në orarin e duhur, pa vonesa si dhe shpalljet e listave të gjykimit në vendet e përcaktuara pranë tabelave të gjykates (dhe në faqen e internetit) ka dhënë një imazh shumë pozitiv për gjykatën si dhe krijimin e kushteve lehtësuese të publikut për marrjen e informacionit të plotë nga gjykata. Po kështu publikimi i vendimit në faqen e internetit i krijon mundësi

palëve në proces (dhe të tretëve) për tu njohur në kohë me arsyetimin e vendimit të kësaj gjykate, në funksion të realizimit të ngritjes së pretendimeve të tyre në Gjykatën e Lartë.

Faqja e internetit është në cdo kohë e aksesueshme për të gjitha llojet e cështjeve që gjykohen në këtë gjykatë (me lidhjet ndihmese) dhe me lehtësi në marrjen e informacionit.

Hedhja e shortit në prezencë të publikut, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë (kryer disa herë) e pasqyruar dhe në internet, është risi që eviton dyshimet e palëve për hedhjen e shortit si dhe ka zvogëluar në mënyrë të ndjeshme paragjykimin e interesave të tyre.

Ndarja e trupave gjykues (në dy kolegje penale + 6 kolegje civile) është në funksion të ngarkesës që ka përballuar kjo gjykatë gjatë vitit 2012, dhe efikasitetit për zgjidhjen brënda afatit të arsyeshëm të cështjeve.

Me urdhra të brendshëm, në funksion të një korrespondence të plotë me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, janë vendosur rregulla të qarta dhe janë parashikuar cështje civile (themeli apo administrative) të cilat ndjekin rradhën e gjykimit të përshpejtuar në një afat kohor më të shkurtër. Këto janë cështje me sensibilitet në publik ose me impakt social dhe në ndihmë të shtresave në nevojë (vërtetim fakti juridik, vjetërsitë në punë, paditë ndaj institucioneve të Sigurimeve Shoqërore, përfitim pensioni, etj.). Po kështu cështje të cilat vijnë në ndihmë të një gjykimi sa më të shpejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të mos krijuar zvarritje në shkallët e gjykimit sic janë: pezullimi i gjykimit, pushimet, masa provizore, masa sigurimi etj.

Çështjet e masave të sigurimit janë regjistruar e shqyrtuar brënda afatit (që parashikon K.Pr.Penale), gjë që siguron efikasitetin e veprimeve hetimore.

I është dhënë përparësi gjykimit të cështjeve që kanë qënë të prishura dhe të kthyera për rigjykim në shkallë të parë dhe Gjykata e Apelit i ka gjykuar si shkallë e parë, si dhe cështjeve të cilat Gjykatë e Lartë i kthen për rigjykim në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit Tiranë në veprimtarinë e saj gjatë vitit 2012 ka patur si qëllim kryesor garantimin e një procesi të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore dhe detyrim kushtetues. Prioritet ka qënë rritja e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet sigurimit të aksesit në gjykatë dhe përfitimit të informacionit të plotë nga ana e qytetarëve.

Miratimi i studimit në lidhje me rritjen e numrit të gjyqtareve do të sjell gjithashtu një përmirësim të kushteve të punës së gjyqtarëve, duke ulur numrin e çështjeve në gjykim për çdo gjyqtar dhe përmirësimin në mënyrë të vecantë në pjesën e gjykimit në një procedurë të saktë dhe gjykim në një kohë të shpejtë, konform standarteve të kërkuara nga KE.

Instalimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatës ka rritur jo vetëm transparencën lidhur me proceset gjyqësore, por njëkohësisht ka bërë një shpërndarje të drejtë ngarkesës së gjyqtarëve në funksion të një administrimi më të mirë të drejtësisë.

Sistemi CCMIS/ICMIS siguron një sistem të integruar dhe të unifikuar të menaxhimit të çështjeve jo vetëm në gjykatën tonë por në të gjitha gjykatat. Ai përmbush kriteret e transparencës nëpërmjet publikimeve *on-line* të skeduleve dhe vendimeve gjyqësore, modulit të shortit elektronik, modulit të inspektimeve në gjykata, ndërveprimit të të dhënave midis Gjykatave të Shkallës së Parë me ato të Apelit, si dhe modulit të statistikave.

Por në fakt kjo arritje ka patur edhe anën e saj negative, në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe Udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” ka nxjerrë urdhrin nr. 1, datë 21.01.2013, sipas të cilit duhet të pezullohet menjëherë publikimi në faqen zyrtare në internet i vendimeve gjyqësore dhe çdo dokumentacioni që mbart të dhëna personale (*të pa anonimizuara*) të subjekteve që marrin pjesë në këto procese gjyqësore deri në marrjen e masave ku publikimi i tyre të bëhet me të dhëna personale të anonimizuara, konform ligjit.



Në këtë drejtim, sic edhe e kemi diskutuar me kolegët dhe stafin e sekretarisë gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë ka lindur nevoja që vendimet gjyqësore të zbardhen nga secili gjyqtar në dy versione, një version me të dhëna të pa koduara, për tu vënë në dispozicion të palëve të interesuara i plotë, dhe një version tjetër me të dhëna të anonimizuara për tu publikuar në faqen e internetit. Megjithatë kjo çështje kërkon një diskutim ndërinstytucional për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të mirë në mënyrë që respektohen kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale por në të njëjtën kohë të mos çenohet transparenca dhe aksesimi në shërbimet e gjykatës.

**Së dyti**, dua të theksoj se në kuadër të ristrukturimit të institucionit me anë të fondeve të Buxhetit të Shtetit është bërë rikonstrukcioni i plotë i sallave të gjykimit, krijimi i dhomave të këshillimit për çdo sallë gjykimi fakt i cili, në këtë vit që po analizojmë, ka sjell plotësimin e një standarti të rëndësishëm lidhur me solemnitetin në gjykim, dhe nga ana tjetër ka sjell një perceptim pozitiv të publikut për mënyrën e sjelljes së gjykatës dhe gjykimin e çështjeve.

Ruajtja dhe zbatimi i kriterëve të solemnitetit në gjykim, veshja e gjyqtarëve me mantele, ruajtja e rregullit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, veshja e detyrueshme e manteleve për avokatët e palëve dhe prokurorëve, si dhe veshje e sekretareve gjyqësore, së bashku në krijimin e rikostruktimit të sallave të gjykimit me dhoma këshillimi konform vendimeve të KLD-se, tregojnë qartë një tablo të plotë të mënyrës së gjykimit të çështjeve nga gjyqtarët me efikasitet të plotë dhe një gjykim solemn aq të mirepritur së pari për gjyqtarët dhe nëpunësit e Gjykatës së Apelit, po ashtu dhe për palët pjesëmarrëse në gjykim.

Në fakt, këtu vlen për t'u theksuar se integriteti i Gjyqtarëve nuk është atribut vetëm i masave që mund të marr kryetari i Gjykatës, por është cilësi e cila krijohet nga vetë gjyqtarët.

Në këtë kuadër, duke qënë se Gjykata e Apelit Tirane është një nga gjykatat më të rëndësishme dhe më me peshë në sistemin e drejtësisë, gjyqtarët e kësaj gjykate së pari duhet ta ndejnë veten personalitete dhe duhet të sillen në mënyrë të tillë.

Të qënit Gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë është një benefic i cili ekziston por dhe ne duhet ta justifikojmë me personalitetin tonë, mënyrën e sjelljes dhe vendimmarrjen e ndershme.

Duhet theksuar se qënia e Gjyqtarit Shkëqim Miri, në detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, qëndrimet e diskutimet e tij në mbledhjet e kësaj Gjykate dhe në gjykim, kanë përcjellë frymën pozitive për pjesën tjetër të kësaj trupe gjyqësore dhe kanë rritur personalitetin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Fakti që në Konferencën e fundit gjyqësore, dy gjyqtarë të kësaj gjykate u zgjodhën anëtarë të rinj të Këshillit të Lartë të Drejtësisë tregon jo vetëm integritetin e gjyqtarëve Artan Broci e Astrit Haxhialushi, por dhe vlerësimin që gjithë komuniteti i gjyqtarëve ka për trupën e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këtë kuadër parashtrojmë se ndryshimet e mëdha të bëra në kuadrin e transparencës si dhe krijimit të perceptimit pozitiv dhe besimit tek publiku, të pasqyrohen në një frymë bashkëpunimi ndërinstytucional midis Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, duke bërë një monitorim për një periudhë një-mujore duke filluar kështu një fushatë pozitive për të gjithë sistemin e drejtësisë në lidhje me sa më lart për të kuptuar së pari ndryshimet e bëra në reformat e deritanishme të të gjithë sistemit të drejtësisë dhe së dyti për t'ia transmetuar këto ndryshime publikut dhe perceptimit të tij për sistemin e drejtësisë.

Ky fakt cmohet se do të përbëjë një risi për të treguar qartë tek publiku bashkëpunimin ndërinstytucional aq shumë të munguar në gjithë këto kohë si dhe për të krijuar një perceptim pozitiv se Gjykata e Apelit Tiranë, si një nga gjykatat më të rëndësishme të RSH, është në rrugën e duhur dhe në zbatim dhe aplikim të rekomandimeve të Raport Progresit të BE për Shqipërinë të vitit 2012.

Pika më determinante e këtij Progres Raporti prek pikërisht krijimin e kushteve për ecurinë e proceseve gjyqësore, të mungesës së sallave të gjyqit dhe dhomave të këshillimit, prek pikërisht publikimin e vendimeve gjyqësore në mënyrë sistematike dhe në kohën e duhur, prek pikërisht mbrojtjen e të

dhënave personale në kuadër të sistemit të drejtësisë. Janë pikërisht këto momente të cilat janë mbajtur parasysh në drejtimin e kësaj gjykate dhe është organizuar puna e saj me efikasitet për të plotësuar këto rekomandime.

Gjithashtu në zbatim të rekomandimeve të Raport Progresit 2012 është parashikuar dhe instaluar në Gjykatën e Apelit Tiranë sistemi Audio incizues për seancat gjyqësore dhe gjithashtu janë zhvilluar trajnime të kancelarëve, nëpunësve gjyqësore dhe administratës gjyqësore në lidhje me implementimin e sistemit IC MIS si dhe ka filluar trajnimi për nëpunësit gjyqësore, sekretarinë gjyqësore dhe për gjyqtarët në lidhje me sistemin Audio-incizues. Gjithashtu është bërë një punë e madhe në lidhje me zhvillimin e proceseve si nga ato të rëndësishmet dhe proceseve të tjera, brenda një afati të parashikuar në K.Pr. Civile dhe K.Pr.Penale, në lidhje me efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe eliminimin e vonesave të paarsyeshme të proceseve gjyqësore.

**Se treti** – Dhënia e vendimeve gjyqësore në zbatim të ligjit është një nga pikat më kryesore në lidhje me përfaqësimin e gjykatës dhe krijimin e besimit të saj tek publiku.

Më lejoni që në mënyrë të përmbledhur të paraqes para Jush ecurinë e punës dhe disa nga dukuritë apo tendencat e vëna re gjatë vitit 2012 në Gjykatën e Apelit Tiranë. Duke vlerësuar së secili nga ju mund të gjejë bashkëlidhur këtij materialit edhe tabelat e detajuara statistikore, po ndalem vetëm në disa të dhëna që në mënyrë të përgjithshme, tregojnë elementet e punës të Gjykatës tonë.

## **II. Përmbledhje e çështjeve të gjykuara për vitin 2012**

Gjatë vitit 2012, në këtë gjykatë janë regjistruar gjithsej **8412 dosje gjyqesore**. Kanë përfunduar me vendim përfundimtar gjithsej **5895 çështje**.

Konkretisht janë gjykuar :

- **3018 çështje civile,**
- **1345 çështje penale**
- **110 çështje administrative,**
- **673 çështje me objekt sigurim padie, rivendosje në afat etj,**
- **192 çështje dhënie në fuqi vendimeve të gjykatave të huaja**
- **538 çështje për vleftësimin e masave të sigurimit.**
- **19 çështje penale ushtarake**

Siç mund të vihet re, lehtësisht gjatë këtij viti, Gjykata e Apelit Tiranë ka përballuar numrin më të madh të çështjeve të regjistruara dhe të gjykuara në këto vitet e fundit.

Është momenti që të shprehemi se në vitin 2012, është bërë një përmirësim i dukshëm për “arsyetimin në kohë” të vendimeve gjyqësore. Megjithatë rezultoi se ka raste sporadike që çështjet e gjykuara janë dorëzuar tej afatit 1 muhor, sic ka raste që për çështje të rëndësishme është shpallur vendimi i arsyetuar, duke mos lënë vend për komente të mediave.

Të gjitha palëve në proceset gjyqësore duhet t’u krijohej mundësia e marrjes së vendimeve të arsyetuara, brenda afatit ligjor, me qëllim që të ushtrojnë ose jo të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë, apo të dërgojnë për ekzekutim vendimet e formës së prerë.

E gjithë trupa gjyqësore ka qënë e angazhuar maksimalisht, me qëllimin e vetëm, që çështjet të gjykohen në afatet ligjore.

### III. Ngarkesa individuale e punës së gjyqtarëve gjatë vitit 2012

Ngarkesa e punës për secilin gjyqtar ka qënë relativisht e madhe. Janë gjykuar mesatarisht nga secili gjyqtar **250 çështje civile** apo **penale**. Por, ka edhe gjyqëtar që kanë gjykuar mbi këtë mesatare.

Ngarkesa e punës për çdo gjyqtar nuk matet vetëm me numrin e çështjeve që ka patur secili për gjykim si relator.

Ajo është e plotë kur krahasohet me numrin e përgjithshëm të çështjeve që gjyqtari ka marrë pjesë në gjykim. Mesatarisht, çdo gjyqtar ka marrë pjesë në plotësim të trupave gjykues në mbi **480 çështje**.

Gjyqtare	Civile	Penale	Penale ushtarake	Dh.f. vend huaj	Masa sigurimi	Administrative	Pez.Riv.	Gjithsej
Alaudin Malaj	155			5	35	5	31	231
Fiqirete Mullaaj	190			12	19	4	46	271
Shkelqim Miri	180			5	34	4	34	257
Zamir Poda	180			11	36	9	46	282
Ilir Toska	200			19	7	8	40	274
Edlira Petri	180			16	19	6	43	264
Gramoz Levanaj	199			14	30	6	34	283
Valdete Hoxha	181			8	35	8	46	278
Agron Papajani	190			12	34	4	43	283
Flutura Skenderi	188			17	28	7	28	268
Artur Kalaja	162			19	46	4	41	272
Dalip Bushi	186			12	34	8	30	270
Hysni Demiraj	190			6	35	6	46	283
Zegjine Sollaku	200			15	29	9	41	294
Edmond Gogo	180			6	34	9	42	271
Gjin Gjoni	180			12	31	7	46	276
Artan Broci	180			3	50	6	35	274
Lefter Jahaj		214	4				1	219
Metush Saraçi		200	5					205
Genti Shala		236	4		2			242
Astrit Haxhialushi		215	1					216
Fatos Qato		232	3					235
Tom Ndreca		244	1					245
Seit Xhoxhaj		4	1					5
Gjithsej	3018	1345	19	192	538	110	673	

Në këtë analizë punë, tërheqim vëmëndjen edhe për gjykimin e çështjeve me mangësi nga Gjykata e Shkallës së Parë që përfshihen në juridiksionin tonë (si në penale ashtu dhe në civile), pasi në shumë çështje është riçeluar hetimi gjyqësor në shkallë të dytë, duke përsëritur pjesërisht apo tërësisht atë, e marrë prova të reja. Ky gjykim kërkon kohë dhe zhvillohet në disa seanca gjyqsore.

Në çështjet penale vështirësit janë edhe më të dukshme, sepse veç mangësive në gjykim të lejuara në shkallë të parë, ato shoqërohen edhe me shkelje të rënda e magësi në procesin e hetimit paraprak. Në veçanti, dosjet penale të ardhura për gjykim, nga organi i akuzës, janë më te meta serioze. Në këtë drejtim mendojmë se duhet të ndërhyhet në dispozitat proceduriale, që gjykata e shkallës së parë të kenë të drejtë që kur çështja nuk është hetuar në mënyrë të plotë e të gjithëanëshme, t'i kthehet për plotësim, organit të akuzës.

Kemi arritur në këtë përfundim sepse shumë çështje penale janë kaluar për gjykim në dy shkallët e gjyqësorit dhe me rekurs në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dhe në fund çështja është rikthyer për rigjykim me detyra konkrete, të cilat në fakt, i përkasin organit të procedimit penal.

Ka çështje që janë kthyer për rigjykim dy, tre apo edhe katër herë, të cilat më pas kanë përfunduar me prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, pasi nuk vërtetohet fajësia e të pandehurit. Kuptohet, që rigjykimi i këtyre çështjeve ka kosto të madhe pasi nga Gjykata e Shkallës së parë dhe të Apelit, harxhohen shumë energji për rishqyrtimin e tyre.

Por, ajo që na shqetëson më tepër është fatura financiare e buxhetit të shtetit. Të arrestuarit, e deklaruar të pafajshëm, dëmshpërblehen me shuma të mëdha, për kohën e qëndrimit në burg.

Gjithashtu vlen të theksohet se Gjykata e Apelit Tiranë ka gjykuar çështje të rëndësishme në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ku peshen më të rëndë në gjykimin e bandave më të rrezikshme e kanë patur gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë drejtim vlen të theksohet se duhet parë funksionimi në të ardhmen të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

#### **IV. Cilësia në Gjykim**

Gjatë periudhës që analizojmë, konstatojmë se vëmëndja e kësaj gjykate është përqëndruar në dhënien e drejtësisë. Për këtë janë mbajtur parasysh të gjitha elementet e cilësisë së gjykimit;

- **respektimi i solemnitetit në gjykim,**
- **transparencës në shqyrtimin e çështjeve**
- **respektimin e procedurave**
- **respektimin e afateve**
- **standartet në komunikim me palët**
- **detyrimet për arsyetimet juridike, logjike, profesionale dhe gjyqsore të vendimeve përfundimtare.**

Rrjedhojë e këtij angazhimi konstatohet se, cilësia e vendimeve gjyqësore ka shënuar rritje, e në veçanti arsyetimi i vendimeve gjyqësore është më cilësor. Cilësia e vendimeve është për Ne, detyra kryesore. Kur Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë duhet të ndryshohet apo kthehet për rigjykim, duhet të shprehemi qartë, për dispozitat ligjore që janë shkelur në këto gjykime. Detyrat e caktuara pas prishjes së vendimeve gjyqësore, duhet të jenë konkrete, të shprehura qartë dhe të zbatueshme.

Por, nga ana tjetër, duhet të jemi të kujdesshëm, në cënimin e vendimeve të shkallës së parë, në veçanti, për çështjet të cilat Gjykata e Lartë i prish vendimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me marrjen e provave dhe jashtë kritereve të parashikuara nga neni 467 të K.Pr. Civile. Ne duhet të rrisim kujdesin tonë që gjatë gjykimit në shkallë të dytë, të cënohen ato vendime që realisht duhen cënuar dhe nga ana tjetër, të evitojmë sa të jetë e mundur, cënimin e atyre vendimeve që mund të korrigjohen në gjykatën tonë. Dhënia e vendimeve të drejta e të bazuara, rrit patjetër besimin e publikut, tek drejtësia.

## **V. Shpejtësia në Gjykim**

Sipas të dhënave statistikore rezulton se shpejtësia në gjykim është në tregues të mirë. Por, ka dhe çështje që janë shqyrtuar në afate kohore mbi dy muaj dhe janë kryesisht ato çështje në të cilat është përsëritur hetimi gjyqësor. Shpejtësia e gjykimit për gjyqtarin llogaritet që nga momenti i shpalljes së çështjes për gjykim.

Kështu, **çështjet civile në 70%** të tyre, janë shqyrtuar në afat kohor nga dy deri në gjashtë muaj, dhe pjesa tjetër mbi këtë afat. Ndërsa afatet e shqyrtimit të **çështjeve penale** janë në një periudhë kohore më të shkurtër.

Është shqetësuese zvarritja e qëllimshme e proceseve gjyqësore. Kështu, herë pas here palët në proces paraqesin dokumenta justifikuese (raporte mjeksore), që e detyrojnë gjykatën të shtyjë gjykimin e çështjes në një ditë tjetër. Kuptohet, që pas kësaj shtyrje shtohen edhe problemet e gjykatës, në njoftimin e palëve nominalisht, në veçanti, kur ka shumë palë në proces. Kjo shkakton vonesa në drejtim të dhënies së vendimit përfundimtar, duke cënuar kështu të drejtën për tu gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

## **VI. Përmbledhje e çështjeve të mbartura nga viti 2012 në vitin 2013**

- 1759 Çështje civile
- 357 Çështje penale
- 357 Çështje Civile (pezullim, rivendosje, sigurim padie)
- 40 Çështje Administrative
- 4 Çështje Dhenie Fuqi vendimi të huaj
- 11 Çështje Penale, Masa Sigurimi



## **VII.Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë gjykuar në Gjykatën e Lartë, ardhur ne vitin 2012.**

Në Gjykatën e Lartë janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, ardhur ne Gjykatën e Apelit Tiranë në vitin 2012, mbi rekursin e palëve në proces **760 çështje civile** të gjykuara, nga të cilat janë prishur, ndryshuar apo pushuar vetëm **32 çështje**, ndërsa pjesa tjetër janë lënë në fuqi, si dhe shqyrtuar me rekurs **377 çështje penale** dhe masa sigurimi, nga të cilat vetëm **27** janë prishur apo ndryshuar, pjesa tjetër është lënë në fuqi.

### **Ceshtje Civile, Pez.Rivend, Administrative**

<b>GJYQTARE</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Lenie ne fuqi</b>	<b>Prishur</b>	<b>Ndryshuar</b>
Alaudin Malaj	66	66		
Fiqirete Mullaj	5	5		
Shkelqim Miri	21	20	1	
Zamir Poda	44	42	1	1
Ilir Toska	66	61	5	
Edlira Petri	7	7		
Gramoz Levanaj	17	17		
Valdete Hoxha	10	10		
Agron Papajani	32	31		1
Flutura Skenderi	72	65	5	2
Artur Kalaja	55	55		
Dalip Bushi	55	50	4	1
Hysni Demiraj	42	41	1	
Zegjine Sollaku	62	57	5	
Edmond Gogo	6	6		
Gjin Gjoni	45	44	1	
Artan Broci	15	15		
Lefter Jahaj	10	7	2	1
Metush Saraçi	22	22		

Genti Shala	12	12		
Astrit Haxhialushi				
Fatos Qato	48	48		
Tom Ndreca	47	46		1

### Çeshtje penale, masa sigurimi

<b>GJYQTARE</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Lenie ne fuqi</b>	<b>Prishur</b>	<b>Ndryshuar</b>
Alaudin Malaj	16	13	2	1
Fiqirete Mulla	9	8	1	
Shkelqim Miri	10	10		
Zamir Poda	6	4	2	
Ilir Toska	4	4		
Edlira Petri	-	-		
Gramoz Levanaj	7	7		
Valdete Hoxha	13	12		1
Agron Papajani	8	8		
Flutura Skenderi	5	5		
Artur Kalaja	11	9	2	
Dalip Bushi	9	9		
Hysni Demiraj	10	9	1	
Zegjine Sollaku	12	7	4	1
Edmond Gogo	9	8	1	
Gjin Gjoni	17	17		
Artan Broci	14	11	3	
Lefter Jahaj	60	58	2	
Metush Saraçi	5	5		
Genti Shala	25	25		
Astrit Haxhialushi	43	40	3	
Fatos Qato	45	42	3	
Tom Ndreca	38	37	1	

Në mbarëvajtje të këtyre të dhënave një rëndësi të vecantë në gjykatën tonë kanë marre mbledhjet e mëngjesit (të cilat zhvillohen me protokoll ku pasqyrohet jo vetëm pjesëmarrja e gjyqtarëve për efekt të vlerësimit, por edhe punimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe diskutime mbi qëndrimet që mbahen në gjykim në lidhje me ceshtje te njëjta dhe vlersimet e gjyqtarëve). Falë këtij komunikimi pozitiv mes gjyqtarëve, punimit të këtyre vendimeve ne gjykatën tonë janë unifikuuar disa qëndrime në lidhje me gjykime të ceshtjeve të së njëjtës natyrë civile.

Ky përbën një fakt pozitiv për shkakun se tashmë palët, në proceset gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë, në një nivel të konsiderueshëm e kanë të qartë pritshmërinë e vendimit gjyqësor, dhe ata vetë janë më të përgjegjshëm në lidhje me rolin e gjykatës dhe të gjyqtarëve.

Sot gjyqtarët janë të mbrojtur totalisht në ushtrimin e detyrës dhe i vetmi obligim në ushtimin e detyrës është përgjegjshmëria në vendimmarrje dhe zbatimi i ligjit në përpikmëri.

Ndryshimi i kushteve për kryerjen e detyrës është i prekshëm, gjyqtari ka infrastrukturën e domosdoshme administrative ndaj mbetet detyrimi ynë për zgjidhjen e çështjes në përputhje me kushtetutën, ligjet dhe brënda një afati të arsyeshëm.

Ligji, profesionalizmi, ndershmëria dhe perkushtimi ne kryerjen e kesaj detyre te rendesishme, do të jetë një nga sfidat e kësaj gjykate dhe e gjithë trupa gjyqsore për të ardhmen.

## **VIII. Administrimi i fondeve për vitin 2012**

Dega e Buxhetit në Gjykatën e Apelit Tiranë për vitin 2012 është orientuar drejt ndërmarrjes së hapave për përmirësimin e sistemit të Planifikimit dhe Manaxhimit të fondit buxhetor në funksion të Zhvillimit të Proceseve Gjyqësore dhe rritjes së shërbimit ndaj publikut me qëllim rritjen e standarteve bashkekohore.

Më poshtë po paraqesim një analizë të hollësishme dhe në detaje për të gjithë zërat e buxhetit për vitin 2012 i përbërë nga katër zëra:

**1. Fondi i pagave të personelit**, i planifikuar sipas organikës së Gjykatës të miratuar nga Ministria e Drejtësisë nr. 126/1 datë 30.03.2012 të planifikuar prej 71 punonjës dhe fakti për vitin 2012 ishte 69 punonjës me një mungesë prej 2 gjyqtarësh, fond i cili është shpërndarë sipas ndryshimeve ligjore ardhur në dinamikë gjatë vitit 2012:

Plani – 76.430.000 lekë

Fakti – 75.457.968 lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 98.7%.

**2. Fondi për shpenzimet operative**, i përbërë në zërat, Materiale dhe shërbime zyre, Shërbime, Shpenzime transporti, Shpenzime të tjera speciale:

Plani – 15.346.500 lekë

Fakti – 15.346.461 lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 99.99%

**3. Fondi për investim**, i përbërë në zërat, Rikonstruksion, Automjete, Pajisje të ndryshme:

Plani – 17.743.000 lekë

Fakti – 17.743.795 lekë

Realizimi i shprehur në përqindje 99.99%

4. Realizimi i të ardhurave për vitin 2012 konsiston në zërat si më poshtë:

**-Qera ambienti**, e shprehur në vlerë 55.500 lekë, shumë e cila i përket muajit Janar 2012, pasi në Shkurt 2012 u bë prishja e kontratës ku ky ambient u ristrukturua dhe u kthye në shërbim të publikut.

- **Të ardhura nga Taksa e Pulla**, për vitin 2012 u realizuan në vlerën 3.240.000 lekë shume e cila është derdhur në buxhetin e shtetit në masën 100%. E krahasuar me vitin 2011 është realizuar 128.5%.

Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit është bërë në mënyrë rigoroze dhe i dokumentuar me dokumentet standarte financiare dhe kontabile sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Duke analizuar ndikimin e buxhetit në veprimtarinë e vitit 2012, kemi detajuar planifikimin e buxhetit për vitin 2013 duke rritur performancën në zbatimin korrekt dhe cdo detaj të zërave të buxhetit në kryerjen e detyrave të misionit.

Gjykata e Apelit Tiranë i ka kushtuar rëndësi të vecantë bashkepunimit me institucione te tjera, si Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës dhe Prokurorine e Apelit.

Në funksion të përcaktimeve në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor për funksionimin e KLD dhe Kodeve procedurale Civile e Penale, është bashkëpunuar në mënyrë institucionale në lidhje me inspektimet tematike apo të vecanta (me Ministrinë e Drejtësisë dhe me KLD), në lidhje me gjykimin e çështjeve civile e penale (me Prokurorine e Apelit) dhe për seminarët e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës ku gjyqtarët e kësaj gjykate kanë marrë pjesë në seminare tematike por edhe në cilësinë e ekspertit për tema të vecanta të organizuara nga ky institucion.

E gjithë kjo veprimtari administrative ka patur qëllim jo vetëm marrjen e masave administrative për gjykimin në kohë dhe brenda afateve të arsyeshme të çështjeve civile dhe penale, por edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në dobi të respektimit të ligjit, përfundimin në kohë dhe brenda afatit të arsyeshëm për çështje që kanë patur sensibilitet publik dhe ngritjen

profesionale, pasurimin e dijeve të gjyqtarëve për çështje të larmishme të praktikës gjyqësore.

Për vitin në vijim, nga ana jonë do të shprehim gadishmërinë për thellimin e bashkepunimit ndërinstitucional, në funksion të arritjes së qëllimit tonë të përbashkët, atë të dhënies së drejtësisë dhe zbatimit drejt të ligjit.

**Kryetari i Gjykatës**

---

**ALAUDIN MALAJ**